

Fjala e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës akademik Hivzi Islami me rastin e dorëzimit të Fletëdëshimit të anëtarit të jashtëm të Akademisë, prof. dr. Kolec Topallit

Kolegë dhe miq të nderuar, zonja dhe zotërinj,

Na ka tubuar sot profesori dhe studiuesi i shquar, miku ynë i dashur, dr. Kolec Topalli, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, tashmë anëtar i jashtëm edhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i zgjedhur në Kuvendin e saj, të mbajtur më 5 Dhjetor 2012, me propozim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të aprovuar nga Kryesia e ASHAK-ut, Do të kemi rastin t'i dorëzojmë sot FLETËDËSHMINË e anëtarit të jashtëm të Akademisë sonë dhe njëkohësisht të ndjekim ligjëratën e tij.

Akademik Topallin e njohim të gjithë, jo vetëm për kontributin e jashtëzakonshëm në fusha të ndryshme të studimeve albanistike, mbi të gjitha në ato të fonetikës historike dhe të gramatikës historike, për kontributet e shumta në studimet e shqipes së hershme dhe asaj të sotme, por edhe si pjesëmarrës të rregullt dhe të zellshëm në konferencat tona shkencore, në tryezat, në diskutimet, në përrurimet dhe në aktivitetet e tjera që organizon Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. E kemi konsideruar gjithnjë si pjesë të rrethit tonë, prandaj dhe zgjedhja e tij u prit e u vlerësua aq lart.

Janë të rrallë studiuesit që kanë gjerësinë dhe thellësinë e interesimeve të akademik Kolec Topallit. Janë të rrallë shkencëtarët që kanë energjinë dhe frytshmërinë e rezultateve të kërkimeve të tilla. Mjafton t'u hedhet një sy botimeve voluminoze, kapitale në fushë të fonetikës dhe gramatikës historike, të realizuara në një periudhë relativisht të shkurtër kohore, për ndërmarrje kaq të gjera, për t'u bindur në seriozitetin e përkushtimit të tij shkencor.

Është mahnitës fakti se gjithë ai vëllim prodhimi kulmor është rezultat i punës së një njeriu, derisa ne do të thoshim se është i denjë për punën e një instituti të tërë, i një ekipi të gjerë kërkuesish e studiuesish. Kur t'i shtojmë gjithë kësaj faktin se akademik Topalli është persekutuar dhe penguar pothuaj gjatë gjithë kohës sa ka zgjatur diktatura komuniste për të realizuar ëndrrën e tij, duke u internuar dhe transferuar në fshatra të largët, atëherë bëhet edhe më e qartë sakrificat e madhe dhe energjia e jashtëzakonshme që i është dashur të bëjë për të rrumbullakuar një opus kaq të gjerë. Pengesat për ta evituar si shkencëtar e gjuhëtar për Topallin nuk patën ndikim demoralizues e frustrues. Përkundrazi, ai gjeti forcën morale, durimin, besimin dhe vullnetin e pashoq se cilësitë e punës së tij shkencore-hulumtuese do të marrin vlerësim publik të merituar. Dhe e morën, dhe kjo na nderon dhe ne si miq e kolegë të tij dhe e nderon edhe shkencën albanologjike kudo në botë.

Kolegë dhe miq,

Më lejoni në fund t'i uroj akademik Kolec Topallit shëndet dhe jetë të gjatë, duke pritur vepra të reja, të frytshme shkencore kështu kuptimplote dhe të rëndësishme për shkencën dhe kulturën tonë dhe ta ftoj të marrë Fletëdëshminë e mirënjohjes sonë për punën e tij, duke e zgjedhur anëtar të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe t'ju ftoj të ndjekim bashkë ligjëratën e tij me titull "Disa rezultate në studimin e zhvillimit historik të gjuhës shqipe".

Akademik Hivzi Islami